P.nr.532/2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike, procesmbajtëse Naxhis Sharani, në lenden penale kundër të akuzuarit L.Sh, nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 398 par.6 lidhur me par.1 të KP,, sipas propozimit akuzues të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 842/2012 të datës 23.04.2012, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në pranin e Prokurorit të shtetit në Prizren Zejnel Kodra, të akuzuarit, të dëmtuarës S.Sh, me date 10.01.2014 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L.SH, nga i ati H., dhe nëna Z. e lindur B., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 24.01.2012, rreth orës 12,15 minuta, në Prizren, në lagjen ..., në rrugën I.K, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurin, si pjesëmarrës në komunikacion rrugor, duke drejtuar automjetin e markës "...", me targa të regjistrimit ..., ngjyrë hiri, vepron në kundërshtim me rregullat e komunikacionit, në atë mënyrë që kur vije përballë market "Kastrati", pa e siguruar paraprakisht , del në krahun e tjetër të rrugës, në të cilin raste humbë kontrollin ndaj automjetit duke e goditur, në pjesën e përparme të anës së majtë automjetin e makrës "...", me targa të regjistrimit ..., të cilën e drejtonte i dëmtuari V.K, ku si pasoj pos dëmeve materiale në automjete, lëndimet të lehta trupore pëson bashkë udhëtarja në automjetin e të pandehurit, e dëmtuara S.Sh, dhe i dëmtuari V.K, lëndime të cilat janë të përshkruara mu për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko ligjor dr. H.Ltë datës 14.04.2012.

Këso dore ka kryer veprën penale të rrezikim i trafikut publik nga neni 398 par.6 lidhur me par.1 të KP,.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 73 të KPK-ës, te akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajë i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale.

Të dëmtuarit V. (E). K, nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, dhe S.Sh, nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet gjyqësore dhe ate në emër të dy mendimeve të ekspertit mjeko ligjor shumën prej 40,88 euro, dhe në emër të ekspertizës mbi aksidentin e komunikacionit shumën prej 40,88 euro, si dhe të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësore në shumen prej 20,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar propozim akuzën PP.nr. 842/2012 të datës 23.04.2012, kundër të akuzuarit L.Sh, nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.3 lidhur me par.1 te KPK-ës,

Gjykata para fillimit të shqyrtimit kryesor ka bërë rikualifikimin e veprës penale të akuzuarit nga neni 297 par.3 lidhur me par.1 te KPK-ës, në nenin 398 par.6 lidhur me par.1 të KP, ligj ky i cili është më i favorshëm për të akuzuarin, e kjo në bazë të nenit 3 par.2 të KP, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013

Prokurori i shtetit Zejnel Kodra në fjalën e tij përfundimtare deklaron: mbes në tërësi pranë propozimit akuzues PP.nr.842/2012 të datë 23.04.2012, të parashtruar ndaj të pandehurit L.Sh, nga fshati Sërbica e Poshte, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 297 par.3 lidhur me par. 1 të KPK-ës, e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të propozim akuzues, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, paraprakisht duke i mare për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

E dëmtuara S.Sh në fjalën e saj përfundimtare deklaron: që nuk parashtron kërkesë pronësoro juridike.

I akuzuari L.Sh, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj në tërësi veprën penale e cila më vihet në barë me propozim akuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren. E tërë kjo ka ndodhur në një moment, kur kam qenë duke drejtuar automjetin tim të markës "...", dhe kam qenë pak për ngut, ngase në automjet e kam pasur kunatën time këtu të dëmtuarën S.Sh, dhe nipin tim L.Sh, i moshës 4 vjeçare, si dhe babai im H.Sh, shkaku që jemi ngutur ka qenë që e kam dërguar për te mjeku nipit L., i cili ka qenë i sëmurë, dhe nga kjo nguti për të arritur më shpejt te mjeku ka ardhur deri te aksidenti, andaj propozoj gjykatës që të cekurat më lartë, si dhe

pranimin vullnetarë të fajësisë nga ana ime ta merr për bazë me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 24.01.2012, rreth orës 12,15 minuta, i akuzuari, në Prizren, në lagjen ..., në rrugën I.K, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurin, si pjesëmarrës në komunikacion rrugor, duke drejtuar automjetin e markës "...", me targa të regjistrimit ..., ngjyrë hiri, vepron në kundërshtim me rregullat e komunikacionit, në atë mënyrë që kur vije përballë market "Kastrati", pa e siguruar paraprakisht , del në krahun e tjetër të rrugës, në të cilin raste humbë kontrollin ndaj automjetit duke e goditur, në pjesën e përparme të anës së majtë automjetin e makrës "...", me targa të regjistrimit ..., të cilën e drejtonte i dëmtuari V.K, ku si pasoj pos dëmeve materiale në automjete, lëndimet të lehta trupore pëson bashkë udhëtarja në automjetin e të pandehurit, e dëmtuara S.Sh, dhe i dëmtuari V.K, lëndime të cilat janë të përshkruara mu për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko ligjor dr. H.Ltë datës 14.04.2012.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin kryesor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban propozimi akuzues, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragraf 1 të KP-ës.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, pendimi i thellë i të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, mosha e të akuzuarit, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim te nenit 463 të KPP-ës.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.532/2012 me datë 10.01.2014

Procesmbajtësja **Gjyqtari**
Naxhis Sharani **Luan Berisha**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.